



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr.379/2 Prot.

Tiranë, më 05.06.2018

V E N D I M

Nr. 57 , datë 05.06.2018

MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT TË MARRË NËPËRMJET KËRKESËS SË PUNONJËSIT *** , PROTOKOLLUAR ME NR. 379 PROT., DATË 30.03.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore, të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenit 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Me anën e kërkesës/informacionit të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 379 prot., datë 30.03.2018, nëpunësi ***** , me detyrë “Specialist Administrimi GIS, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit”, pranë Bashkisë Vlorë, ka ngritur pretendimin se, nga ana e njësisë përgjegjëse nuk i është vënë në dispozicion vendimi i konfirmimit si nëpunës civil, sipas të pikës 1 dhe 3, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të pikës 7, të Kreut VI, të Vendimit, nr. 243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”.

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të këtij rasti rezultoi se punonjësi ***** , ka filluar punë për herë të parë në Bashkinë Vlorë, në datën 08.01.2016, si “Nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Specialist Administrimi GIS, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit”, nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur, në kategorinë ekzekutive, bazuar në nenin 22, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”.

Në zbatim të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Kreut VI, të Vendimit, nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”, ky nëpunës i është nënshtruar periudhës së provës, e cila ka zgjatur një vit nga dita e emërimit dhe aktualisht kjo periudhë ka përfunduar, që në datën 08.01.2017.

Gjatë periudhës së provës, vërtetohet se nëpunësi ***** ka përmbushur detyrimin për të punuar nën udhëzimet e një nëpunësi të vjetër civil (i cili, në datën 01.02.2017, ka dhënë vlerësimin pozitiv të tij, për periudhën 1-vjeçare) dhe ka përfunduar me sukses programin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s “Prezantimi me Administratën Publike”, në periudhën 13-17 Qershor 2016 dhe në testimin përfundimtar është vlerësuar me 19, nga 26 pikë të mundshme (shoqëruar me certifikatën përkatëse).

Pas kësaj, në përmbushje të detyrimit të parashikuar prej pikës 6, të Kreut VI, të Vendimit, nr. 243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”, nga ana e eprorit direkt është kryer edhe vlerësimi i rezultateve individuale në punë për këtë punonjës, për periudhën 08.01.2016-01.02.2017, sipas procedurës së parashikuar nga neni 62, “Vlerësimi në punë”, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil”, të ndryshuar

Nga këqyrja e aktit të vlerësimit vërehet se Zyrtari Raportues, e ka vlerësuar me nivelin 1, “Shumë mirë”, shoqëruar edhe me shënimet përkatëse në rubrikën “Komente të zyrtarit raportues”, por nga ana tjetër konstatohet se nuk është nënshkruar nga të gjithë zyrtarët e tjerë përgjegjës, të ngarkuar nga ligji për realizimin e procedurës së vlerësimit (konkretisht, mungon nënshkrimi i Zyrtarit Kundërfirmues dhe atij Autorizues).

Në vijim të kësaj analize, pavarësisht mangësive të evidentuara më sipër, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, ka përgatitur, paraprakisht, aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil, në kategorinë “nëpunës civil” në përfundim të periudhës së provës, akt i cili në përmbushje të kërkesave të ligjit, duhet të merrej bazuar në vendimin e “eprorit direkt” (ky akt është administruar në dosje, por nuk ka numër protokoll dhe datë, ç’ka tregon se ai nuk ka formë të rregullt ligjore).

Nisur nga sa u parashtrua më sipër, arrihet në përfundimin se procedura e konfirmimit si nëpunës civil për nëpunësin *****, nuk është përfunduar, ashtu si përcaktohet në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit, nr. 243 datë

18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive” dhe pikës 7, të Kreut VI, të Vendimit, nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive.

Në rastin konkret, pas hartimit të vlerësimit të punës në fund të periudhës së provës nga ana e eprorit direkt, procesi duhet të vijonte me nënshkrimin dhe komentet e zyrtarëve të përcaktuar nga ligji (*Zyrtari Kundërfirmues dhe ai Autorizues*) e pas kësaj, nëse vlerësimi do të ishte pozitiv (*të paktën “kënaqshëm”*), eprori direkt duhet të hartonte vendimin për konfirmimin e nëpunësit civil, të arsyetuar, i cili sipas pikës 12, të aktit të përmendur më sipër, brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit, duhet ti njoftojë nëpunësit dhe njësisë përgjegjëse.

Kjo e fundit, sipas pikës 13, të Vendimit nr. 243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”, brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të eprorit direkt, duhet të nxirrte aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit.

Në këtë rast nuk është respektuar asnjë nga kërkesat e mësipërme të legjislacionit për shërbimin civil dhe fakti që ka kaluar një periudhë dy vjeçare nga momenti kur duhet të ishin kryer këto veprime, është i mjaftueshëm për t’u konsideruar thyerje disiplinore, për nëpunësin që nuk ka kryer si duhet e në kohë detyrën, siç është parashikuar shprehimisht, në pikën 8, të kreut VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” e nenin 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse që të marrë masat e nevojshme për përfundimin e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin ***** dhe konkretisht të orientojë aktorët e këtij veprimi administrativ, që në këtë rast janë *Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues*, për të përfunduar procesin, duke nënshkruar e bërë komentet përkatëse, në rubrikat e aktit të vlerësimit në fund të periudhës së provës.
2. Të kërkojë nga eprori direkt i punonjësit ***** , që në zbatim të pikës 7, të Kreut VI, të Vendimit, nr. 243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”, të nxjerrë

vendimin e arsyetuar për konfirmimin e nëpunësit civil në fund të periudhës së provës dhe në zbatim të pikës 12, të vendimit të sipërpërmendur, të njoftohet nëpunësi i interesuar, për këtë akt administrativ.

3. Njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë Vlorë, në zbatim të pikës 13 të Kreut VI të Vendimit, nr. 243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive*”, (duke respektuar afatet kohore) duhet të finalizojë procesin, me aktin e deklarimit të statusit, i cili duhet ti njoftohet nëpunësit *****.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vlorë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke paraqitur të gjitha aktet administrative që vërtetojnë masat e marra.
6. Njësia përgjegjëse e institucionit, të njoftojë të gjithë punonjësit e përfshirë në këtë proces dhe që janë ngarkuar me detyra specifike në vendimin e Komisionerit, pasi në përfundim të afatit të paralajmërimit, në rast se nuk janë marrë masa për rregullimin e ligjshmërisë, përgjegjësia disiplinore dhe ligjore do të jetë individuale për nëpunësin që nuk ka vepruar në përputhje me ligjin.
7. Të njoftohen për këtë vendim Bashkia Vlorë, njësia përgjegjëse e këtij institucioni dhe nëpunësi *****.
8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e ligjshmërisë, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rivendosur ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

Punoi: Alda Xhaxhiu, Inspektor i K.M.SH.C-së

Pranoi: Ilija Kukumi, Drejtor në Drejtorin e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ

Miratoi: Arbana Basha, Drejtor i Përgjithshëm i Inspektimit dhe Mbikëqyrjes